

VENDIM
Nr.119, datë 6.3.1997

PËR MIRATIM PROKURIMI TË DREJTPËRDREJTË

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI;

1. Të miratojë blerjen e baterive për teknikën luftarake nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, sipas procedurave të blerjes me prokurim të drejtpërdrejtë për një fond deri në 10 milionë lekë.

2. Fondet sipas pikës 1 të këtij vendimi do të përballohen nga zëri i buxhetit kontingjencë i planifikuar për 3-mujorin e parë të vitit 1997.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi